

№ / ID: 02-052 / 04-005202 / 25

Data / Date: 16.12.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) ka zhvilluar dhe realizuar me sukses një sërë aktivitetesh dhe detyrash funksionale, të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit administrativ, përmirësimin e proceseve të brendshme dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve njerëzore në Komunën e Skenderajt. Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje të plotë me Planin Vjetor të Punës së NJMBNJ-së, si dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore dhe udhëzimet administrative përkatëse, është përmbyllur me sukses procesi i ristrukturimit të pozitive brenda institucionit. Ky proces është zhvilluar në bazë të analizës së nevojave organizative, respektimit të standardeve ligjore dhe planifikimit strategjik institucional. Ristrukturimi ka kontribuar në përmirësimin e organizimit të brendshëm, qartësimin e përgjegjësive dhe rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrave zyrtare.

NJMBNJ ka siguruar një qasje të rregullt, transparente dhe të barabartë në menaxhimin e pushimeve vjetore për të gjithë zyrtarët. Të gjitha procedurat janë realizuar përmes sistemit elektronik përkatës, duke mundësuar regjistrimin, aprovimin dhe monitorimin e saktë të ditëve të pushimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, janë sistemuar, verifikuar dhe përditësuar të gjitha dosjet personale të zyrtarëve. Ky proces është realizuar në përputhje me standardet arkivore dhe kërkesat ligjore për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar ruajtjen e dokumentacionit në mënyrë të sigurt, të saktë dhe të qasshme.

Po ashtu, janë kryer korrigjime, azhurnime dhe verifikime të vazhdueshme të të dhënave të stafit në sistemin SIMBNJ, duke siguruar që informacionet të jenë të plota, të sakta dhe të harmonizuara me gjendjen faktike të personelit të Administratës së Komunës së Skenderajt. Vlerësimi i rezultateve të punës është realizuar përmes sistemit SIMBNJ, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara.

Aktivitetet shtesë të realizuara gjatë vitit 2025

- Është ofruar mbështetje e vazhdueshme për zyrtarët në çështje administrative, procedurale dhe në marrëdhëniet e punës.
- Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet periodike dhe statistikore të kërkuara nga Ministria për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP) dhe nga Kryetari i Komunës.
- Është kontribuar në zhvillimin profesional të stafit përmes koordinimit, organizimit dhe ndjekjes së trajnimeve të ndryshme.
- Janë zbatuar me përpikëri të gjitha ligjet, rregulloret, udhëzimet administrative dhe aktet nënligjore që lidhen me fushën e burimeve njerëzore.

Të dhënat e përgjithshme

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet komunale është **1,355**

Numri i përgjithshëm i grave të punësuar në institucionet komunale është **746**

Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë udhëheqës në institucionet komunale (arsim, shëndetësi, kulturë dhe sport) është **63**, prej të cilëve **25** janë nga gjinia femërore

Numri i përgjithshëm i personave me nevoja të veçanta të punësuar është **2**, nga të cilët:

- 1 në Administratën e Komunës;
- 1 në QKMF.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve nga komunitetet jo-shumicë është **7**

Përveç të dhënave të përgjithshme, në raport janë të përfshira edhe të dhënat për vitin 2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk ka pranuar asnjë kërkesë apo njoftim lidhur me zyrtarë të akuzuar nga organet e drejtësisë. Po ashtu, nuk është evidentuar asnjë rast pezullimi nga detyra i zyrtarëve komunalë për shkak të procedurave gjyqësore.

Të gjitha aktivitetet dhe të dhënat e cekura më lart janë pjesë përbërëse e Planit të Përgjithshëm të Punës së NJMBNJ-së dhe janë të regjistruara dhe të dokumentuara në sistemet përkatëse. NJMBNJ mbetet e përkushtuar në përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve administrative.



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore